BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Bazuar në nenin 36 paragrafi 1, nënparagrafi 1.17, nenin 65 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 11 të Rregullores për Pagesat Ndërkombëtare, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 3 dhjetor 2015, miratoi këtë:

# Udhëzim Nr. 02/2015
# Për Identifikimin e Urdhërpagesave Ndërkombëtare Dalëse

## Neni 1
## Qëllimi

Ky Udhëzim përcakton detyrat e ofruesit të shërbimeve dhe të dhënat për identifikim unik të urdhërpagesave ndërkombëtare dalëse.

## Neni 2
## Detyrat e ofruesit të shërbimeve

a. Ofruesi i shërbimit të pagesës do të sigurojë paraqitjen e këtyre të dhënave në urdhërpagesën ndërkombëtare dalëse dhe do ta bëjë pranimin e urdhërpagesës ndërkombëtare dalëse vetëm nëse këto të dhëna janë paraqitur në pajtim me këtë udhëzim.

b. Ofruesi i shërbimit të pagesës do të ruajë dhe do të trajtojë këto të dhëna sikurse të dhënat e tjera të përfshira në urdhërpagesën ndërkombëtare dalëse në pajtim me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse.

## Neni 3

## Të dhënat për identifikimin e urdhërpagesave ndërkombëtare

a. Të dhënat për identifikimin unik të urdhërpagesave ndërkombëtare dalëse kanë të bëjnë me faturën apo dokumentin tjetër të pagueshëm në bazë të të cilit iniciohet pagesa përkatëse.

b. Të dhënat për identifikim unik të urdhërpagesave ndërkombëtare dalëse do të paraqiten nga paguesi në urdhërpagesën ndërkombëtare dalëse.

c. Të dhënat për identifikim unik të urdhërpagesave ndërkombëtare dalëse janë të specifikuara në vijim:

| Nr. | 1. | 2. | 3. | 4. | 5. |
| --- | --- | --- | --- | --- | --- |
| **Emërtimi i së dhënës (fushës)** | Deklarimi mbi mbështetjen e pagesës në një dokument të pagueshëm | Referenca e dokumentit të pagueshëm | Data e dokumentit të pagueshëm | Shuma totale e dokumentit të pagueshëm | Përshkrimi i hollësishëm i arsyes së pagesës |
| **Përmbajtja e së dhënës (fushës)** | Deklarimi nëse pagesa bazohet në një faturë apo dokument tjetër të pagueshëm ("Po" ose "Jo") | Referenca në format të lirë (16 çfarëdo karakteresh) | Data në format standard (dd.mm.vvvv) | Shuma në format decimal (0.00 – 99999999.99) | Përshkrimi në format të lirë (min. 50, max. 255 çfarëdo karakteresh) |
| **Përshkrimi i së dhënës (fushës)** | Shënohet "Po" nëse pagesa mbështetet në një dokument të pagueshëm; shënohet "Jo" nëse pagesa nuk mbështetet në një dokument të pagueshëm | Nëse ka më shumë se 16 karaktere, shënohen 16 karakteret e fundit; nëse ka më pak se 16 karaktere, shënohen karaktere "0" (zero) në anën e majtë deri sa të përbëhen gjithsej 16 karaktere | Shënohet data e lëshimit të dokumentit të pagueshëm | Shënohet shuma totale e cila figuron në dokument të pagueshëm dhe e cila mund të jetë e ndryshme nga shuma e pagesës | Shënohet arsyeja e pagesës në një mënyrë sa më specifike që të jetë e mundur |
| **Statusi i së dhënës (fushës)** | E obligueshme | E obligueshme nëse e dhëna nën Nr. 1. është "Po" | E obligueshme nëse e dhëna nën Nr. 1. është "Po" | E obligueshme nëse e dhëna nën Nr. 1. është "Po" | E obligueshme nëse e dhëna nën Nr. 1. është "Jo" |

**Neni 4**
**Shtojca**

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi është forma e Urdhërpagesës Ndërkombëtare.



M.

**Neni 5**
**Hyrja në Fuqi**

Ky Udhëzim hyn në fuqi më datë 1 janar 2016 dhe shfuqizohet Udhëzimi për Identifikimin e Urdhërpagesave Ndërkombëtare Dalëse i datës 28 qershor 2012

Bedri Hamza

Kryesues i Bordit Ekzekutiv

# URDHËR PAGESË NDËRKOMBËTARE / MEĐUNARODNI PLATNI NALOG / INTERNATIONAL PAYMENT ORDER

*Logo e Bankes / Logo banke/ Logo of the bank* — 20 Ref:

**50: Të dhënat mbi Urdhëruesin / Podaci nalogodavca / Ordering Customer Details**

☐ Rezident/ Rezident Resident: ☐ JoRezident/ NeRezident/ NonResident:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. i llogarisë / Broj računa / Account No.: | | Nr. i ID-së ose Regjistrimit të Firmës / Broj ID ili broj biznisa / ID No. or Registration No.: | |
| Emri / Ime / Name: | | Tel: | |
| Adresa / Adresa / Address: | | Shteti / Država / Country: | |

**59: Të dhënat mbi Përfituesin / Podaci Primaoca / Beneficiary Details**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Nr. i llogarisë / Broj računa / Account No.: | | | |
| Emri / Ime / Name: | | | |
| Adresa / Adresa / Address: | | Shteti / Država / Country: | |

**56: Të dhënat mbi Bankën ndërmjetësuese /Podaci Banke Posrednika / Intermediary Bank Details**

Kodi SWIFT / SWIF Kod / SWIFT Code: ________ Kodi i bankës/ Bank Kod / Bank Code: ________

Emri / Ime / Name: ________

**57: Të dhënat mbi Llogarinë e Bankës së Përfituesit / Podaci Računa Banke Primaoca / Beneficiaries Account with Institution details**

Kodi SWIFT / SWIF Kod / SWIFT Code: ________ Kodi i bankës/ Bank Kod / Bank Code: ________

Emri / Ime / Name: ________

Adresa / Adresa / Address: ________ Shteti / Država/ Country: ________

**32A: Shuma e transferimit /Iznos za transfer / Transfer Amount**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Valuta / Valuta / Currency: | | Shuma / Iznos / Amount: | . | Kursi i këmbimit / Kurs / Exchange Rate: | . |
| Shuma me fjalë / Iznos slovima / Amount in words: | | | | | |

**70: Të dhënat mbi pagesën /Podaci o nalogu / Payment Details**

________

**71A: Tarifat / Naknade /Charges:**

Tarifat e palëve të treta / Naknade Treće Strane / Third Party Charges: ☐ Urdhëruesi/ Nalogodavac/OUR: ☐ Përbashkët/ Podeljen/SHA : ☐ Përfituesi/ Primaoc/BEN:

Tarifa e Bankës / Naknada Banke / Bank Charge : ________ Gjithsejt Vlera / Ukupan Iznos / Total Amount: ________ .

**Deklarata e klientit nëse transferi bazohet në dokument / Client declaration if payment is based on document / Deklaracija klijenta ako je nalog zasnovan na dokumentu :**

| | | Referencat e dokumentave / Referenca dokumenta / Document References: | Shuma / Iznos / Amount: | Data / Datum / Date: |
|---|---|---|---|---|
| Dokumentet e prezantuara/ Predstavljena Documenta/ Documents presented: | ☐ | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |
| Nuk ka Dokument / Nema Dokumenata / There are No Documents: | ☐ | | | |

Please complete this form for payments of *10.000.00*Euros or more, or equivalent in other currencies. / Ju lutemi të plotësoni tabelën më poshtë për pagesat *10.000.00*euro e më shumë, apo ekuivalente në valutat tjera. / Molimo vas da popunite ovaj obrazac za plaćanje od *10.000.00*evra ili više , ili ekvivalent u drugim valutama.

| Kodi i Transakcionit / Kod Transakcije / Transaction Code: | Përshkrimi i Transakcionit / Opis Transakcije / Description of the transaction: | Shuma / Iznos / Amount: (Fill out, if amount is split / Të plotësohet nëse shuma është ndaras /Popuniti ako je iznos podeljen) |
|---|---|---|
| | | |
| | | |

Të dhënat shtesë në lidhje me llojin e transaksionit, shumat tjera nëse ekzistojnë. / Dodatni detalji o osnovnoj prirodi transakcije ukjucujci I druge iznose , ako ih ima. / Additional details on underlying nature of the transaction, including further amounts if applicable:

________

*Data Efektive/ Datum Valute / Value Date:*

Bank- Nënshkrimi vula dhe data / Potpis pečat i datum/Signature seal and date

Klienti / Klijent / Client - Nënshkrimi / Potpis / Signature:

***Deklarata e klientit /Izjava klijnta/Customer Declaration:***

*Unë/Ne e udhëzojmë bankën të ekzekutoj këtë urdhër sipas të dhënave të dhëna më lart. Urdhri do të realizohet në përputhje me rregulloret e brendshme të bankes. Klienti Urdhërues i përmbahet rregullatives ligjore të ven Për çdo informatë te mangët nga ana e klientit, banka nuk mban përgjegjësinë në rast të kthimit të mjeteve. Unë/Ne deklarojmë se do ti përmbush/im të gjitha shpenzimet/obligimet shtesë që mund të paraqiten në lidhje me transferin e mjeteve.*

*Ja / Mi nalalem/o banku da izvrši ovu naredbu prema gore navedenim detaljima. Nalogć e se izvršiti u skladu sa internim aktima banke. Klijent nalogodavac ć e primenjivati nacionalne zakonske regulative. Banka neć e biti odgovorna za povratak sredstava zbog nedostatka informacija od klijenta. Ja / Mi izjavljujemo da sve dodatne troškove koje mogu imati u vezi sa transferom novca, ja/mi ć emo nadoknaditi.*

*I/We instruct the bank to execute this order according to the details given above. The order will be effected in accordance with the bank internal regulations. Ordering Customer will apply national law regulations. The bank will not be responsible for the return of funds due to the lack of information from the client. I/We declare that, all extra cost that may bear in connection with money transfer I/we will compensate.*